



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar-Dhjetor 2010

Mars, 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

TREGUESIT FISKALE KRYESORË PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2010.....	2
Analiza e të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2010	3
Vështrim i përgjithshëm	3
Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera	5
Taksimi i konsumit (indirekt)	5
Taksimi direkt	8
Taksimi i pasurisë.....	9
Taksa të tjera	10
Të ardhurat e fondeve speciale.....	10
Analiza e shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2010.....	13
Vështrim i përgjithshëm	13
Shpenzimet korrente.....	14
Shpenzimet e personelit	14
Shpenzimet për interesa	15
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	16
Shpenzimet për subvencione	16
Shpenzimet për fonde speciale	17
Shpenzimet të pushtetit lokal	18
Pagesa e papunësisë	18
Shpenzimet kapitale	19

TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIU DHËN JANAR-DHJETOR 2010

Nga te dhenat e thesarit te Ministrise se Financave, per vitin 2010 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 324.9 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 2.6 përqind më të ulëta së parashikimi dhe 8.7 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 361.5 miliardë leke (shih tabelen 1). Në linjë me politikën fiskale stabilizuese të Qeverisë, dhe në vijim të rishikimit në ulje të shpenzimeve për 2010 kundrejt buxhetit (rishikim që u finalizua me miratimin e buxhetit të ri në Korrik 2010), shpenzimet gjate 2010 ishin 4.8 përqind më të ulëta se në vitin 2009, dhe 10.2 miliardë më të ulëta se planifikimi sipas aktit normativ. Ulja e shpenzimeve gjatë 2010 kundrejt një viti më parë reflektohet më shumë në shpenzimet kapitale, që janë reduktuar me rreth 29.8 përqind në bazë vjetore; shpenzimet korente janë rritur me 5.6 përqind në bazë vjetore; huadhenia neto është ulur me 5.6 miliardë lekë kundrejt një viti më parë.


Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në 36.6 miliardë deri në fund të 2010, 1.5 miliardë lekë më pak se planifikimi, dhe me rënie të ndjeshme kundrejt vitit 2009 që u karakterizua nga një politikë fiskale ekspansioniste (80.9 miliardë lekë ishte deficiti fiskal në fund të vitit 2009). Deficiti është financiar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 362 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 26.3 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 10 miliardë lekë, në linjë me planifikimin.

Nje zhvillim i rendesishem per financat publike ne kete fund viti ishte miratimi i Aktit normativ, ne muajin dhjetor. Duke pare ecurine e te ardhurave dhe shpenzimeve ne buxhetin e konsoliduar si dhe duke ruajtur targetin e politikës fiskale ne terma te deficitit fiskal per 2010 ne 38 miliardë leke, akti normativ ri-alokoi disa shpenzime nga pjesa “korente” dhe “huadhenia neto” e buxhetit ne pjesen e shpenzimeve kapitale, ne nivelin e 5 miliardë leke. Keto fonde shtese u alokuan per Ministrine e Puneve Publike dhe Transportit ne programin “Rrjeti i Rrugeve Nacionale”, per vazhdimin e financimit te disa projekteve te nisura, me financim te brendshem.

Tabela 1. Treguesit kryesore të buxhetit të konsoliduar për vitin 2010

Miliardë lekë	Janar-Dhjetor '09	Janar-Dhjetor '10	Akti normativ 2010
TE ARDHURAT TOTALE	290.0	324.9	333.7
SHPENZIMET TOTALE	379.9	361.5	371.8
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	283.9	299.9	300.1
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	95.9	67.3	71.0
BALANCA FISKALE	-80.9	-36.6	-38.1
BALANCA PRIMARE	-44.6	+5.0	+3.8

Grafik 1. Te ardhura dhe shpenzime totale ne vite, sipas gjashtemujoreve



ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - DHJETOR 2010

Vështrim i përgjithshëm

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore arritën në 324.9 miliardë lekë, duke realizuar planin në masën 97.4 përqind dhe duke tejkaluar të ardhurat e një viti më parë me rreth 8.7 përqind. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 97.2 përqind ndaj parashikimit, ose rreth 223.1 miliardë lekë nga 229.7 miliardë lekë të planifikuara, me rritje vjetore 6.8 përqind; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 11.9 miliardë lekë nga 15.5 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar dhe nga 12.1 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat në fondet speciale arritën 53.8 miliardë lekë nga rreth 53.9 miliardë lekë të planifikuara, dhe kundrejt 49.8 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 8 përqind; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 4.6 miliardë lekë nga rreth 4.4 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 31.5 miliardë lekë nga 23.7 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 32.7 përqind.

Sipas nivelit të qeverisjes, në buxhetin e konsoliduar, të ardhurat e qeverisë qendrore përbejnë për këtë periudhë 80 përqind të të ardhurave gjithsej; të ardhurat e qeverisjes lokale (nga taksa dhe tarifa) vetëm 3 përqind; ndërsa të ardhurat e fondeve speciale rreth 17 përqind të të ardhurave gjithsej në buxhetin e konsoliduar.


Nga këndvështrimi i klasifikimit ekonomik të të ardhurave, të dhenat tregojnë se Shqipëria ka një sistem tatimor që takson me shumë konsumin kundrejt të ardhurave dhe pasurisë, dhe ky tipar ka ardhur duke u theksuar vitet e fundit. Të ardhurat nga tatimet mbi të ardhurat dhe pasurinë së bashku përbejnë 15 përqind të të ardhurave gjithsej, ndërsa të ardhurat që mbliidhen nga taksimi i konsumit (indirekt) përbejnë gati gjysmën (47 përqind) e të ardhurave të buxhetit të konsoliduar.

Tabela 2. Të ardhurat në tremujorë për 2009-2010

EMERTIMI	2009				2010			
Miliarde leke	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
TE ARDHURAT TOTALE	71.8	72.2	76.1	77.2	79.1	78.6	86.4	87.9
Nga tatime dhe dogana	47.8	51.7	56.3	53.1	49.2	54.7	61.7	58.4
Nga pushteti vendor	3.0	3.9	2.6	2.6	2.7	3.6	2.4	3.2
Nga fondet speciale	13.0	12.5	11.9	11.8	15.2	15.4	15.3	14.2
Te ardhura jo tatimore	7.7	3.2	4.4	7.3	11.8	3.2	6.6	9.8


Sipas agjencive te mbledhjes, per nga te ardhurat e realizuara kundrejt nje viti me pare administrata doganore paraqitet me mire per periudhen, me 119 miliarde leke te mbledhura, 2.9 perqind me pak se parashikimi por me rritje 12.4 perqind kundrejt vitit 2009. Sipas zerave te te ardhurave qe mbledhin doganat, bie ne sy performanca e rentes minerare ne eksport, qe eshte rritur me rreth 2.6 here, kryesisht si pasoje e rritjes se eksporteve te burimeve natyrore si dhe ndryshimeve ne normen e taksimit dhe ne strukturen e takses gjate gjysmes se pare te vitit 2010. Edhe te ardhurat nga akciza ne dogane kane rritje vjetore te ndjeshme me 22.1 perqind, ne vijim edhe te ndryshimeve ne listen e mallrave me akcize ne mesin e ketij viti. Ndersa te ardhurat nga TVSH ne import jane 9.6 perqind me te larta se nje vit me pare, ndikuar nga ri-gjallerimi i importeve gjate ketij viti (rritja e importeve per 12 mujorin eshte 10.8 perqind, ne vlere) dhe pjeserisht nga efekti i rritjes se akcizes per disa mallra.

Grafik 2. Rritja vjetore, sipas gjashtemujoreve



Administrata tatimore ka hasur me shume veshtiresi ne mbledhjen e te ardhurave gjate ketij viti, dhe ka mbledhur per periudhen vetem 1 perqind te ardhura me shume se nje vit me pare, dhe 2.8 perqind me pak se parashikimi. Tatimet kane patur nje ulje te ndjeshme kundrejt 2009 te te ardhurave nga TVSH, me 10.6 perqind, qe reflekton rritjen e ndjeshme te kontributit te eksporteve ne shitjet totale te bizneseve qe paguajne TVSH krahasuar me strukturen historike (eksportet kane TVSH zero).

Grafik 3. Te ardhurat ne buxhetin e konsoliduar janar-dhjetor, sipas llojeve dhe ne vite



Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

Taksimi i konsumit (indirekt)

Të ardhurat nga taksimi i konsumit (indirekt) arritën në 152.5 miliardë lekë, ndarë në 114 miliardë lekë nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe 38.5 miliardë lekë nga akcizat.

Tatimi mbi vlerën e shtuar

Nga TVSH janë mbledhur gjithsej për 12-mujorin 114 miliardë lekë, ose 3.6 përqind më shumë se një vit më parë. Te ardhurat e mbledhura janë 6.5 përqind më pak se parashikimi në Aktin Normativ.

TVSH mbledhet mbi mallrat e importuar dhe mbi transaksionet brenda vendit. Nga TVSH ne import janë mbledhur gjatë vitit 2010 rreth 84.8 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 9.6 përqind. TVSH ne import ndikohet direkt nga vlera (CIF) e mallrave që importohen. Gjatë vitit 2010, vlera e importeve ka pësuar një rritje rreth 11 përqind kundrejt një viti më parë, e ndikuar nga rritja e volumit të importeve (rreth 2.9 përqind krahasuar me 2009), rritja e përgjithshme e çmimeve të lëndëve të para (*commodities*) dhe produkteve bujqësore në tregjet ndërkombëtare krahasuar me 2009, dhe zhvlerësimi i monedhës shqiptare ndaj euros dhe dollarit (përkatësisht me 5 dhe 9 përqind). Gjatë 2010 importet janë dominuar nga mallrat e konsumit të përditshëm (ushqime, pije, duhan, lëndë djegëse), tekstile dhe këpucë si dhe materiale ndërtimi dhe metale.


Nga Administrata Tatimore janë mbledhur për vitin 2010 rreth 29.2 miliardë lekë, mbi shitjet brenda vendit, me rënie të ndjeshme kundrejt një viti më parë, prej rreth 11 përqind. Sektorët e ekonomisë me rënie më të ndjeshme të pagesave të TVSH-se krahasuar me 2009 kanë qënë ndërtimi dhe telekomunikacioni, për arsye të qarta : sektori i ndërtimit ka më pak vlerë të shtuar gjatë 2010, edhe si pasojë e reduktimit të investimeve publike ; ne sektorin e telekomunikacioneve ka patur një nivel të lartë investimesh që kanë akumuluar TVSH të kreditueshme, si dhe ulje të tarifave të telefonisë celulare. Gjatë 2010 është rritur ndjeshëm dhe niveli i TVSH-së së rimbursuar, sepse eksportet kanë qënë pjesë dominuese e aktivitetit ekonomik në vend dhe sic dihet Shqipëria takson eksportet me normë TVSH-je zero. Rreth 6 miliardë lekë ka qënë TVSH e rimbursuar gjatë vitit 2010.

Përsa i takon strukturës së tatimit, që nga 1 Janari 2010 pragu për regjistrimin me TVSH është 5 milionë lekë (rreth 38 mijë Euro) qarkullim vjetor nga 8 milionë. Qëllimi i këtij ndryshimi është rritja e formalizimit të transaksioneve mes biznesit të vogël dhe të madh. Niveli i ri konsiderohet më “normal” për këtë fazë të zhvillimit ekonomik dhe është më afër eksperiencave të vendeve të tjera. Për profesionet e lira, kufiri i regjistrimit për TVSH u vendos në 2 milion lekë qarkullim vjetor.

Zhvillim tjetër i rëndësishëm gjatë vitit 2010 ishte përjashtimi nga TVSH i shërbimeve të arsimit privat dhe publik.

Përsa i takon bazes së taksueshme, për periudhën 12-mujore, subjektet tatimpagues të TVSH janë në total 20,557 (xhiro vjetore mbi 5 milionë lekë), nga rreth 18,000 që ishin aktive në 2009. Tregtia dhe shërbimi përbëjnë sektorët dominues, me 67 përqind të të gjithë subjekteve me TVSH. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga TVSH-ja për 12-mujorin në vite.

Grafik 4. Të ardhurat nga Tatimi mbi Vleren e Shtuar ne vite, per 12 mujorin



Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Dhjetor janë rreth 7.3 miliardë lekë, 3.4 përqind me pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 655 milionë lekë, ose 8.3 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.79 përqind. Lidhur me tarifat preferenciale, gjatë këtij viti po zbatohen reduktimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit (CEFTA), me Turqinë dhe me vendet e Bashkimit Europian.

Akciza

Të ardhurat nga akciza gjatë këtij viti ishin 38.5 miliardë lekë, me rritje vjetore 15 përqind. Të ardhurat nga akciza janë ndikuar direkt nga ecuria e konsumit për këta artikuj dhe nga ndryshimet e politikës për këtë taksë. Lidhur me ndryshimet ligjore që kanë përfshirë akcizën, në shtator të vitit 2009 u rrit akciza e kafes (e papjekur nga 50 lekë në 70 dhe e pjekur nga 100 në 140 lekë për kg) dhe akciza e cigares (nga 40 lekë për pakete në 50 lekë); ndërsa në qershor të vitit 2010 ndryshimet ishin akoma më të ndjeshme: u ul akciza mbi kafën e papjekur (nga 70 lekë në 30 lekë për kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli “naftë virgin” me nivel akcize 50 lekë për litër, shtohen në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarret, gomat, pilat dhe bateritë primare,

ambalazhet; ndryshon taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem në shumë fikse. Ndryshimet më thelbësore për nga impakti mbi të ardhurat kanë një kohë të shkurtër aplikimi (që nga korriku i vitit në vijim) dhe analiza e efektit neto të tyre është e vështirë. Megjithatë, për më shumë qartësi, në vijim janë pasqyruar të ardhurat sipas artikujve dhe sipas agjencive të mbledhjes.

Duke iu referuar te dhenave për 11 mujorin (të detajuara), te ardhurat nga akciza mbi cigaren janë rritur për 2010 me 19.8 përqind; futja në listë e mallrave të reja me akcizë ka dhënë një efekt të përafërt mbi të ardhurat prej rreth 1.2 miliard; kanë qendruar ne te njejtin nivel të ardhurat nga taksimi i pijeve alkoolike ne 1.9 miliarde leke; ndërsa të ardhurat nga taksimi i karburanteve është rritur me rreth 9.4 përqind.


Nga administrata doganore janë mbledhur rreth 24.7 miliardë lekë, që përbëjnë 64 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birres së importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (sic jane mallrat qe i janë shtuar listës). Në krahasim me vitin 2009, të ardhurat nga akciza në doganë janë 4.5 miliardë lekë më shumë, ose rreth 22 përqind. Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata për periudhën ka qënë si vijon: sasia e karburanteve të zhdoganuar për periudhën Janar - Dhjetor 2010 është 484.4 mije ton, me rritje 12 përqind; sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar – Dhjetor 2010 është 4500 ton, me rritje vjetore prej 10 përqind; muajt e fundit eshte rritur sasia e cigareve te zhdoganuara krahasuar me muajt e fundit te vitit te kaluar, si reagim i kompanive ndaj anuncimit dhe miratimit te politikës se rritjes se akcizes se cigareve, qe pritet te hyje ne fuqi ne shkurt te vitit 2011; sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar - Dhjetor 2010 është 33.9 milionë litra, me një rënie prej 7.3 përqind, e ndikuar nga rritja e prodhimit vendas te ketij artikulli; kafeja e zhdoganuar për periudhën ka qënë 8.4 përqind më pak.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 13.8 miliardë lekë, me rritje vjetore 4.2 përqind. Të ardhurat nga akciza të mbledhura nga tatimet përbëjnë rreth 36 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Sipas grup mallrave, të ardhurat nga karburantet e prodhuara në vënd kanë pësuar një ulje prej rreth 50 përqind si pasoje e ngadalesimit te aktivitetit te ARMO gjate ketij viti; të ardhurat e mbledhura nga cigaret, përmes pullave fiskale, janë rritur me 14.3 përqind, si pasojë e rritjes së nivelit të taksimit të cigareve në Shtator 2009 dhe sasise se importuar muajt e fundit; të ardhurat e mbledhura nga pijet alkoolike me pullë akcize kanë qëndruar pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Tabela 3. Të ardhurat nga akciza sipas mallrave

Të ardhura, miliardë lekë	12 mujor 2009	12 mujor 2010	Ndryshimi %
Akciza mbi cigaret	9.1	10.9	+19.8
Akciza karburante	21.3	23.3	+9.4
Akciza pije alkoolike	1.9	1.9	-
Të tjera	1.2	2.4	+100

Grafik 4. Te ardhurat nga Akciza janar-dhjetor ne vite



Taksimi direkt

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 27.1 miliardë lekë, ose 0.7 përqind më shumë se një vit më parë.

Për të kuptuar më mirë ecurinë e këtij taksimi, zërthejmë të dhënat sipas burimeve të ndryshme të të ardhurave individuale të taksueshme. Te ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qenë rreth 8.4 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 5 përqind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jo-publik kanë qenë 7.4 miliardë lekë me rritje vjetore prej 5.7 përqind, cka tregon rritje të indikatorit “*wage bill*”, që ndikohet nga niveli i punësimit dhe niveli i pagave; të ardhurat nga interesat për periudhën janë në nivelin 2.9 miliardë lekë, pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Tabela 4. Të ardhurat nga taksimi individual sipas burimit të të ardhurave

Të ardhura, miliardë lekë	12 mujor 2009	12 mujor 2010	Ndryshimi %
Paga sektori publik	8.0	8.4	+5
Paga sektori jo publik	7.0	7.4	+5.7
Interesa	3.0	2.9	-3.3
Dividendë	0.8	1.3	+62.5
Shitje pasuri e paluajtshme	2.2	2.4	+9.1
Të tjera	5.8	4.7	-19.0

Në uljen e nivelit të të ardhurave të mbledhura nga tatimi mbi te ardhurat personale krahasuar me vitin 2009 ka ndikuar zëri i të ardhurave të mbledhura mbi çmimin e shitjes në privatizimet e kompanive shtetërore (në masën 10 përqind). Gjatë vitit 2009 të ardhurat nga privatizimi për periudhën 11-mujore ishin rreth 1.8 miliardë lekë, kundrejt zero lekë të këtij viti.


Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga taksimi i aktivitetit të biznesit për vitin 2010 arritën në 19.9 miliardë, me një rritje të lehtë vjetore prej 1.5 përqind. Ky taksim përfshin tatimin mbi fitimin (të ardhurat e kompanive) e subjekteve me xhiro vjetore mbi 8 milionë lekë dhe taksimin e bizneseve të vogla (me xhiro vjetore nën 8 milionë lekë). E para mbledhet dhe administrohet në nivel qeverie qendrore, e dyta nga pushteti vendor.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat e kompanive gjatë 2010 kane qene 17.6 miliarde, 2.7 përqind më të larta se një vit më parë. Ecuria mujore e mbledhjes se tatim fitimit ka qene shume e "crregullt" gjate ketij viti. Vecanerisht gjate gjashtemujorit te pare te 2010 mbledhja e te ardhurave te tatim fitimit ka qene ndjeshem nen nivelin e pritshem per arsye te rishikimit ne ulje te kesteve te parapagimit nga subjektet tatimpagues, si dhe te rritjes se teprices kreditore te tatim fitimit krahasuar me nje vit me pare. Mbledhja e tatimit eshte permiresuar ndjeshem gjate muajit gusht, shtator, nentor dhe dhjetor. Numri i subjekteve aktivë, që i nënshtrohen tatim fitimit, sipas të dhënave më të përditësuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për 2010 është rritur me 14 përqind kundrejt mesatares së vitit 2009.

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël për vitin 2010 kane shenuar nje nivel prej 2.3 miliarde leke, duke qene 6.8 përqind më të ulëta se një vit më parë, edhe pse numri i subjekteve aktivë që i nënshtrohen kësaj takse rezultojnë të jetë rreth 9 përqind më i lartë se mesatarja e vitit 2009. Administrimi dhe mbledhja e taksës vazhdojnë të mbeten problematike. Është duke përfunduar pajisja e të gjithë tatimpaguesve me kasa regjistruese dhe kjo pritet të japë efekt vecanerisht në formalizimin e transaksioneve të bizneseve të vogla dhe në deklarimin real të xhiros së tyre, mbi të cilën llogaritet taksa vendore e biznesit të vogel. Nga të dhënat e DPT për numrin e tatimpaguesve subjekte te kësaj takse, për 10-mujorin kjo shifër është rreth 62 mije tatimpagues nga 57 mije të 2009, dmth me rritje 9 përqind.

Grafik 5. Te ardhurat nga taksimi direkt janar-dhjetor ne vite



Taksimi i pasurise

Përfshin tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Eshte prej kohesh nje pjese problematike e sistemit tatimor, persa i takon te ardhurave te mbledhura kundrejt te ardhurave potenciale qe mund te mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i taksës mbi pasurine rezultojnë te jete pergjithesisht efektiv persa i perket bizneseve dhe institucioneve / organizatave dhe ndjek te njejten tendence ne arritjen e nivelit te parashikuar te te ardhurave me taksat dhe tarifet e tjera te aplikueshme nga njesite vendore (tarifat e pastrimit, gjelberimit, ndriçimit). Nderkohe, eksperienca nuk eshte e njejte per kategoria "Familjare" te taksapaguesve. Ketu tendenca ne grumbullimin e kesaj takse eshte e ulet, dhe njesite e qeverisjes vendore kane mjaft probleme ne administrim dhe ne detyrimin per pagimin e taksës. Per nivelin ende te larte te informalitetit, ka mjaft veshtiresi ne vleresimin e bazes se taksueshme, per arsye te mangesive ne deklarimin real te pasurive. Per

vitin 2010 taksat mbi pasurine arrijne ne 1.9 miliarde leke, ose 25 perqind me te larta se nje vit me pare. Ne totalin e te ardhurave tatimore ne Shqiperi ky grup taksash ze vetem 0.71 perqind, kundrejt 6 perqind qe eshte mesatarja e vendeve te OSBE.

Taksa te tjera


Të ardhurat nga taksat nacionale për vitin 2010, janë 18.6 miliardë lekë me një rritje prej 39 përqind. Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë patur taksat e mbledhura mbi kazinotë dhe lojrat e fatit (rritje vjetore 65 përqind) dhe renta minerare (rritje vjetore 100 përqind). Taksa të rëndësishme në këtë grup janë dhe taksa mbi transaksionin e makinave te perdorura, te ardhurat nga te cilat jane ne renie me 7.2 perqind kundrejt vitit 2009 dhe taksa e qarkullimit rrugor.

Gjatë vitit 2010 taksa e importimit të automjeteve të përdorura u shfuqizua dhe u zëvendësua me taksën mbi transaksionin e automjeteve të përdorura, duke shtrirë taksimin edhe mbi shitblerjet e tyre brenda vendit, duke mbajtur të pandryshuar objektivin mjedisor të kësaj politike.

Ndryshime pati edhe në strukturën dhe nivelet e rentës minerare, taksë që mblihet mbi nxjerrjen, shfrytëzimin dhe eksportin e burimeve natyrore, të cilat pësuan rritje.

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për vitin 2010 arritën në 11.9 miliardë lekë ose 2.1 përqind më pak se një vit më parë. Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogel dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 7.7 miliardë lekë nga 10.4 të parashikuara, dhe 5.9 përqind më pak se vitin e kaluar.

Grafik 6. Te ardhurat nga taksat vendore janar-dhjetor ne vite




Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për vitin 2010 arritën në 53.8 miliardë lekë, me një rritje prej 8 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për vitin 2010. Nga totali i fondeve speciale, 51.6 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ose 3.4 përqind më shumë se një vit më parë. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 11-mujore të 2010 rezulton se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor

shtetëror dhe sektori privat) prej 3.5 përqind, ose rreth 13 mije kontribues, kundrejt mesatares vjetore të 2009. Për sektorin privat rritja e numrit të të punësuarve (mesatare 11-mujor 2010 kundrejt mesatares 12 - mujor 2009) është 5.8 përqind ose afërsisht 12 mije kontribues më shumë. Megjithatë, brenda kësaj shifre, *subjektet me TVSH kanë një rritje të kontribuesve prej 7 përqind* (ose 11 mije kontribues) ndërsa subjektet e biznesit të vogël një rritje më modeste prej 2.9 përqind. Numri mesatar i kontribuesve në sektorin publik (buxhetorë dhe ndërmarrje shtetërore) rezultoi i njëjtë me mesataren e vitit 2009.

Grafik 7. Te ardhurat ne Fondet Speciale janar-dhjetor ne vite




	EMERTIMI	12 Mujor 2009 mld leke	12 Mujor 2010 mld leke	%
	TE ARDHURAT NE BUXHETIN E KONSOLIDUAR	298.9	324.9	+8.7
A	Te ardhura tatimore	270.8	288.8	+6.6
I	Tatimet mbi te ardhurat	46.4	47.0	+1.3
<i>I.1</i>	<i>Tatimi mbi te ardhurat personale, nga i cili:</i>	26.8	27.1	+1.1
	Tatimi mbi pagen ne sektorin publik	8.0	8.5	+6.3
	Tatimi mbi pagen ne sektorin jopublik	7.0	7.4	+5.7
	Tatimi mbi te ardhurat nga interesat	3.0	2.9	-3.3
	Tatimi mbi te ardhurat nga dividendet	0.8	1.3	+62.5
	Tatimi mbi te ardhurat nga shitja e pasurise	2.2	2.4	+9.1
	Te tjera	5.8	4.7	-18.9
<i>I.2</i>	<i>Tatimi mbi te ardhurat nga biznesi</i>	19.6	19.9	+1.5
	Tatim fitimi	17.1	17.6	+2.9
	Taksa mbi biznesin e vogel	2.5	2.3	-8.0
II	Te ardhurat ne fondet speciale	49.8	53.8	+8.0
III	Taksimi i pasurise	1.7	1.8	+5.9
	Tatimi mbi ndertesat	1.1	1.2	+9.1
	Tatimi mbi token bujqesore	0.38	0.39	+2.6
	Taksa mbi kalimin e pasurise	0.2	0.23	+0.0
IV	Taksat indirekte mbi mallrat dhe sherbimet	143.6	152.5	+6.2
IV.1	Tatimet mbi shitjen	110.1	114.0	+3.4
	TVSH mbi shitjet brenda vendit	32.7	29.2	-10.6
	TVSH mbi mallrat e importuara	77.4	84.8	+9.6
IV.2	Akcizat	33.5	38.5	+15.0
	Mbi karburantet	21.3	23.3	+9.4
	Mbi alkoolin dhe nenproduktet e tij	1.9	1.9	0.0
	Mbi duhanin dhe nenproduktet e tij	9.1	10.9	+19.8
	Te tjera (kafe, etj)	1.2	2.4	+100.0
V	Taksimi i automjeteve	4.9	5.0	+2.0
	Taksa per regjistrimin e automjeteve	0.7	0.8	+14.3
	Taksa e qarkullimit rrugor	4.2	4.2	+0.0
VI	Te tjera taksa mbi mallra dhe sherbime (nacionale)	9.2	14.4	+56.5
	Taksa mbi transakcionet e makinave te perdorura	2.8	2.6	-7.1
	Renta minerare	1.6	3.4	+112.5
	Taksat mbi kazinote dhe lojrat e fatit	3.3	5.2	+57.6
	Te tjera	1.5	3.2	+113.3
VII	Taksat mbi tregtine nderkombetare	7.9	7.3	-7.6
VIII	Te tjera taksa lokale	7.2	7.0	-2.8
B	Te ardhura jo tatimore, nga te cilat:	23.7	31.5	+32.9
	Tarifa sherbimesh	4.2	3.0	-28.6
C	Grante	4.4	4.6	+4

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2010

Vështrim i përgjithshëm

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit në fund të vitit 2010, arriten në rreth 361.8 miliardë leke, nga rreth 371.8 miliardë leke të parashikuara, duke u realizuar në rreth 97.3 përqind ose me një mosrealizim prej rreth 10.0 miliardë leke. Në këtë mënyrë këto shpenzime në fund të vitit 2010 arriten në rreth 29.5 përqind e Produktit të Brendshëm Bruto, nga rreth 33.2 përqind që arriten një vit më parë. Kundrejt vitit 2009, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 18.1 miliardë leke më të ulta, ose rreth 4.8 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute dhe ritmi i rritjes së tyre në disa vite, jepet në grafikun e mëposhtem.

Grafik 8. Shpenzimet e përgjithshme janar-dhjetor




Në analizen e shpenzimeve **duhet mbajtur parasysh edhe fakti** se, shpenzimet e kryera nëpërmjet përdorimit të fondit rezerve të Keshillit të Ministrave dhe kontigjencës, janë reflektuar në zërat e shpenzimeve ku ato janë kryer, si më poshtë:

Fondi rezerve i Keshillit të Ministrave, prej rreth 2.48 miliardë leke, i ekzekutuar deri në fund të vitit 2010, është përdorur në rreth 23.3 milionë leke për shpenzime për paga, në rreth 3 milionë leke për shpenzime për sigurime shoqërore, në rreth 505.4 milionë leke për subvencione, në rreth 1310.7 milionë leke për shpenzime të tjera korentë dhe në rreth 636.5 milionë leke për investime.

Fondi i kontigjencës prej 2.7 miliardë leke, i ekzekutuar deri në fund të vitit 2010 është përdorur në rreth 1.5 miliardë leke për shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes dhe rreth 1.2 miliardë leke për subvencion.

Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë vitit 2010, shpenzimet korentë zënë rreth 82.9 përqind, nderkohe që shpenzimet për investime zënë rreth 18.7 përqind (diferenca është huadhenia neto, me rreth -1.6 përqind). Një vit më parë struktura e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit të shtetit të realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor, ishte rreth 74.7 përqind shpenzimet korentë dhe rreth 25.3 përqind shpenzimet kapitale.


Grafik 9. Struktura e shpenzimeve janar-dhjetor



Shpenzimet Korrente

Shpenzimet korente, kane arritur ne rreth 299.9 miliarde leke ose rreth 98.4 perqind te planit me ndryshime (plan qe mban ne konsiderate edhe perdorimet e fondit rezerve te buxhetit te shtetit, perdorimet e fondit te kontigjences per rritjen e pagave dhe pensioneve, perdorimin e fondit te kontigjences per ruajtjen e deficitit si dhe rishperndarjet e fondeve buxhetore ndermjet ministrive dhe institucioneve) ose rreth 4.7 miliarde leke me pak se **ky plan me ndryshime**. Shpenzimet korente arrihen ne rreth 24.4 perqind te PBB-se nga rreth 24.8 perqind qe ishin nje vit me pare. Krahasuar me vitin e kaluar, keto shpenzime rezultojne rreth 16 miliarde leke me te larta ose rreth 5.6 perqind me shume.

Grafik 10. Shpenzimet korente janar-dhjetor




Shpenzimet e Personalit

Brenda shpenzimeve korente, **shpenzimet e personalit**, qe perfaqesojne rreth 21.9 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate vitit 2010, rezultojne me nje kursim prej rreth

1.9 miliarde leke ose rreth 2.7 perqind me pak se plani i ndryshuar, rrjedhoje kjo kryesisht e kursimeve ne zerin shpenzime per paga.

Shpenzimet e personelit ne fund te vitit 2010 arriten ne rreth 5.35 perqind e PBB-se, nga rreth 5.45 perqind qe ishte nje vit me pare. Krahasuar me nje vit me pare, shpenzimet e personelit rezultojne rreth 3.4 miliarde leke me te larta, ose rreth 5.5 perqind me shume, nderkohe qe shpenzimet per paga rezultojne rreth 3.7 miliarde leke me te larta, ose rreth 6.9 perqind me shume dhe shpenzimet per kontribute te sigurimeve shoqerore rreth 0.3 miliarde leke me te ulta, ose rreth 3 perqind me pak.

Grafik 11. Shpenzimet per personelin janar-dhjetor




Shpenzimet per paga jane rreth 490 milione leke me pak se parashikimi i periudhes, duke qene ne te njejten kohe rreth 3.1 miliarde leke me te larta se nje vit me pare ose rreth 6.4 perqind me shume se nje vit me pare, nderkohe qe shpenzimet per sigurimet shoqerore jane rreth 190 milione leke me pak ose rreth 2.3 perqind me te ulta, se nje vit me pare.

Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet per interesa, qe perfaqesojne rreth 13.9 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate vitit 2010, krahasuar me planin e ndryshuar rezultojne me nje kursim prej rreth 272 milione leke, kursim ky i evidentuar ne interesat e brendeshme me rreth 17 milione leke dhe ne interesat e jashtme, me rreth 255 milione leke. Ne kete menyre shpenzimet per interesa arriten ne rreth 3.39 perqind e PBB-se nga rreth 3.17 perqind qe ishin nje vit me pare.

Kundrejt vitit te kaluar shpenzimet per interesa rezultojne rreth 5.3 miliarde leke me te larta ose rreth 14.6 perqind me shume, rrjedhoje kjo e interesave te brendeshme te cilat rezultojne rreth 4.2 miliarde leke me te larta se nje vit me pare dhe e interesave te jashtme qe jane rreth 1.1 miliarde leke me te larta. Ecuria e shpenzimeve per interesa ne vite jepet nga grafiku i meposhtem:


Grafik 12. Shpenzimet per interesa janar-dhjetor



Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes, gjate vitit 2010 arrihen ne rreth 33.3 miliarde leke duke qene rreth 1.3 miliarde leke me te larta se nje vit me pare ose rreth 3.9 perqind me te larta. Keto shpenzime ne fund te vitit 2010 arrihen ne rreth 2.7 perqind te PBB-se, nga rreth 2.8 perqind qe ishin nje vit me pare.

Grafik 13. Shpenzimet O&M janar-dhjetor




Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet per subvencione, ne fund te vitit 2010, rezultojne ne rreth 99 perqind te planifikimit vjetor ose rreth 37 milione leke me pak se ky planifikim. Kundrejt nje viti me pare keto shpenzime rezultojne rreth 1.5 miliarde leke me te larta ose rreth 76.4 perqind me shume, rrjedhoje kjo e shlyerjes se detyrimeve te prapambetura te ndermarrjeve te ujesjellesve per

energji elektrike, per te cilen ne masen 500 milione leke eshte perdorur fondi rezerve i buxhetit te shtetit dhe ne rreth 1.2 miliarde leke fondi i kontigjences. Subvencionet ne vitin 2010 arriten ne rreth 0.29 perqind te PBB-se, nga rreth 0.18 perqind qe rezultuan nje vit me pare.

Grafik 14. Shpenzimet per subvencione janar-dhjetor




Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore gjate vitit 2010, rezultojne rreth 97.4 perqind e planit te ndryshuar. Kjo situatë është rrjedhojë e mosrealizimit prej rreth 2.1 miliarde leke te shpenzimeve per sigurimet shoqerore dhe e mosrealizimit me rreth 0.5 miliarde leke te shpenzimeve per sigurimet shendetesore. Krahasuar me nje vit me pare shpenzimet per sigurimet shoqerore rezultojne rreth 5.6 miliarde leke me te larta ose rreth 7.6 perqind me shume, ndersa shpenzimet per sigurimet shendetesore rezultojne rreth 2.2 miliarde leke me te larta ose rreth 9.4 perqind me te larta, duke bere qe shpenzimet per sigurimet ne total te rezultojne rreth 7.7 miliarde leke me te larta ose rreth 8.0 perqind me shume se viti i kaluar.

Deri ne fund te vitit 2010, rreth 1.75 miliarde leke jane perdorur **per kompensimin ne vlerë te pronareve**.


Grafik 15. Shpenzimet per sigurime shoq.&shend janar-dhjetor



Shpenzime të Pushtetit Lokal

Shpenzimet per buxhetin lokal kane arritur ne rreth 30.8 miliarde leke duke rezultuar rreth 2.8 miliarde leke me te ulta se nje vit me pare ose rreth 8.4 perqind me pak. Keto shpenzime arrihen ne rreth 2.5 perqind te PBB-se nga rreth 2.9 perqind qe rezultuan vitin e kaluar. Ecuria e shpenzimeve te pushtetit lokal per periudhen janar-dhjetor per disa vite jepet nga grafiku i meposhtem.

Grafik 16. Shpenzimet per pushtetin lokal janar-dhjetor




Pagesa e Papunësisë

Pagesa e papunesise rezulton me nje realizim prej rreth 99.2 perqind ose vetem rreth 8 milione leke me pak se parashikimi vjetor, duke qene ne te njejten kohe rreth 114 milione leke me shume ose rreth 13.1 perqind me shume se nje vit me pare.

Ndihma ekonomike gjate vitit 2010 arriti ne rreth 16.7 miliarde leke, duke qene ne te njejten kohe rreth 645 milione leke me shume ose rreth 4.0 perqind me e larte se nje vit me pare.

Rreth 1.0 miliarde leke jane **perdorur per kompensimin e ish te perndjekurve politike**, me nje diference prej rreth 400 milione leke kundrejt parashikimit.

Grafik 17. Shpenzimet per mbrojtjen sociale janar-dhjetor




Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale ne fund te vitit 2010 jane realizuar ne nivelin 94.1 perqind te planit vjetor te ndryshuar, duke rezultuar me nje mosrealizim prej rreth 4.2 miliarde leke. Per rrjedhoje investimet ne vitin 2010 arrihen ne rreth 5.5 perqind e PBB-se nga rreth 8.4 perqind qe rezultuan nje vit me pare.

Brenda ketyre shpenzimeve, investimet me financim te brendeshem jane realizuar ne rreth 96.8 perqind, pra me nje mosrealizim prej rreth 1.5 miliarde leke, nderkohe qe investimet me financim te huaj jane realizuar ne rreth 101.4 perqind te planit vjetor me ndryshime, duke rezultuar me nje tejkalim prej rreth 0.3 miliarde leke.

Grafik 18. Shpenzimet kapitale janar-dhjetor



Struktura e investimeve kapitale te realizuar gjate periudhes janar-nentor 2010 eshte rreth 70.9 perqind nga financimi i brendeshem dhe rreth 29.1 perqind nga financimi i huaj.

Ecuria e investimeve kapitale me financim te brendeshem dhe me financim te huaj gjate njembedhjetemujoreve ne disa vite jepet nga grafiku i meposhtem.

Grafik 19. Financimi i investimeve publike janar-dhjetor

